

VLERËSIMI VULLNETAR LOKAL PËR BASHKINË SHKODËR

Shtator, 2021

Autorë:
**Agron Haxhimali dhe Aida Cacaj, Shoqata e Bashkive
Filip Vila, Bashkia Shkodër**

Ky publikim është përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen financiare të Fondacionit Hanns Seidel, Shqipëri. Ky botim pasqyron qëndrimet e Shoqatës së Bashkive dhe jo domosdoshmërisht të Fondacionit Hanns Seidel. Autorët garantojnë pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra nga materialet e referencës të përdorura.



SHOQATA E BASHKIVE TË SHQIPËRISË



FONDACIONI HANNS-SEIDEL



Tabela e përmbajtjes

Fjala e hapjes - angazhimi i kryetarit të bashkisë	4
Prezantimi i bashkisë	6
Bashkia Shkodër në shifra	4
Avantazhet konkurruese	7
Planet dhe strategjitë kryesore	10
Përfshirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në zhvillimin lokal të Shkodrës	12
Vlerësimi i OZhQ	14
Objektivi 1	14
Objektivi 2	20
Objektivi 3	21
Objektivi 4	22
Objektivi 5	26
Objektivi 11	28
Objektivi 12	33
Objektivi 15	35
Objektivi 17	37
Zbatimi, monitorimi dhe rishikimi	40
Plani i Punës	40
Plani i punës për zbatimin e Planit Lokal për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë Shkodër	41

Fjala e hapjes - angazhimi i kryetarit të bashkisë

Zhvillimi i Qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor është dhe do të mbetet një prioritet i punës së bashkisë Shkodër, i kryetares, stafit dhe këshillit bashkiak. Ne, po përqëndrojmë përpjekjet tona mbi zbatimin e Axfordës 2030 për qytetarët dhe komunitet tona.

Ne, dëshirojmë gjithashtu të jemi kontribues të iniciativave të Kombeve të Bashkura për Axfordën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Ne, të gjithë me mundësitë tona modeste përpiqemi të gjejë zgjidhje lokale, rajonale dhe globale për një të ardhme të qëndrueshme.

Si bashki e Shkodrës, ne kemi bërë disa punë të mira në zbatimin e Axfordës 2030 në nivelin lokal. Bazuar në angazhimin tonë të gjatë në partneritete rajonale dhe me shoqërinë civile ne jemi përpjekur ti përafrohemi sa më shumë objektive të Agjendës 2030.

Dokumentat strategjikë të miratuar nga bashkia na ndihmojnë për tu orientuar në mënyrë sistematike veprimet tona drejt qëndrueshmërisë në kuptimin e Agjendës 2030 me qëllimin e vetëm që të jemi qytet i përshtatshëm për të ardhmen.

Gjatë gjithë bashkëpunimit tonë me partnerët dhe shoqërinë civile i kemi kushtuar rëndësi punës për Vlerësimin Vullnetar Lokal (VLR), duke përkrahur zbatimin lokal të OZhQ sipas udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara, duke marrë rolin që i takon vetë bashkive.

Ky botim shpreh angazhimet tona për të paraqitur raporte të rregullta se ku qëndrojmë si bashki Shkodër në zbatimin e OZhQ.

Ne besojmë fuqimisht se raportimi dhe monitorimi janë mjete të rëndësishme që na ndihmojnë për tu përmirësuar dhe orientuar mirë dhe drejt së ardhmes së qëndrueshme.

Të dhënat e tona ne duhet ti bëjmë transparente dhe qytetarët duhet ti njohin me qëllim që të jenë aktorë dhe faktorë të ndryshimit dhe zhvillimit.

Në emër të bashkisë Shkodër si dhe në cilësinë time si Kryetare e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, në emër të Zhvillimit të Qëndrueshëm, unë do të doja të inkurajoja me forcë të gjitha kolegët e mi në 60 bashkitë e tjera të Shqipërisë të ndjekin rrugën e tyre drejt arritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm social ekonomik dhe mjedisor për bashkitë tyre dhe për vendin tonë të mrekullueshëm.



Së fundmi, një falënderim ju drejtoj të gjithë kolegëve nga departamentet e përfshira të administratës tonë, ekspertëve nga Shoqata e Bashkive si dhe për të gjithë të tjerët që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti.

Ne u jemi gjithashtu shumë mirënjohës Fondacionit Hans Seidel për mbështetjen që na mundësoi për të përgatitur këtë raport.

Faleminderit!

Voltana Ademi

Kryetare

Prezantimi i bashkisë

Bashkia Shkodër në shifra

Sipërfaqja:	873 km ²
Popullsia:	Numri i popullsisë në Bashkinë Shkodër është 208,618 banorë, me përqendrimin më të lartë të popullsisë në qytetin Shkodër me 115,215 banorë. Ndërsa për njësitë administrative përqendrimin më të lartë të popullsisë e ka njësia Rrethina me 26,399 banorë dhe atë më të ulët njësia administrative Shosh me 1,862 banorë.
Punësimi:	Numri i të punësuarvenë bashkinë Shkodër është 25,058 persona, nga të cilët: 28 % në sektorin publik;72 % në sektorin privat.
Ndërmarrje:	Totali i bizneseve në Bashkinë Shkodër është 5,675 nga të cilët:1,266 janë biznese të mëdha dhe 4,409 janë biznese të vogla.
Bujqësi dhe blegtori:	Sektori bujqësor ka si produkte kryesore perimet, duhanin, patatet, ullinjtë dhe frutat, gjithashtu sektori blegtoral është tepër i zhvilluar, ku spikasin feramat dhe baxhot e përpunimit të qumështit.
Industria:	Zona industriale e Shkodrës e cila ndodhet në periferi të qytetit është pjesërisht e zënë me biznese por ka hapësira të lira për shfrytëzim. Bizneset kryesore operuese janë: prodhim këpucësh dhe konfeksione, përpunime të materialeve elektrike dhe duralumin, përpunim druri, përpunim i duhanit, nënprodukte të mishit, ëmbëlsira etj.
Ndërtimi:	Shkodra është një zonë dinamike dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Me lehtësimin e procedurave të marrjes së lejeve të ndërtimit, ky sektor paraqet një tendencë në rritje. Në fushën e ndërtimit kemi një numër prej 53 subjektesh që ushtrojnë aktivitetin e tyre.
Shërbime:	Përsa i përket fushës së shërbimeve, Bashkia Shkodër si qendër e madhe administrative ofron shërbime të ndryshme për qytetarët e saj duke filluar nga shëndetësia, arsimit, transporti publik etj. Gjithashtu në këtë sektor operojnë shumë biznese të cilat ofrojnë shërbime si: tregtare, transporti, telekomunikacioni, bankare, furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, shërbime turistike etj.

Avantazhet konkurruese

Pozita gjeografike

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe një pjesë e saj me Bashkinë Lezhë. Ajo përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethina, Shalë, Shosh dhe Velipojë). Me një ekosistem të larmishëm (Liqeni i Shkodrës, lumi Buna, Drin, Kir, si dhe kurora malore), shumë pranë detit Adriatik dhe pika më e afërt e transitit të tregut të Bashkimit European.



Forcë pune profesionale me paga konkurruese

Kostot e punës në Shqipëri, dhe në Shkodër janë akoma nga më të ulëtat në rajon. Aktualisht në Shkodër ka një numër të lartë force pune të specializuar kjo falë prezencës së shkollave profesionale dhe kurseve të ndryshme të formimit. Popullsia në moshë të re, prania e universitetit si dhe njohuritë e gjuhëve të huaja si italisht, anglisht dhe gjermanisht, japin një tjetër avantazh për investuesit e huaj dhe vendas, të cilët do të gjejnë mbështetje në këto kapitale njerëzore. Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar varion sipas sektorëve të ekonomisë.

Resurset natyrore

Sistemi hidrografik “Liqeni i Shkodrës - Lumi Drin – Lumi Buna”, grumbullon ujërat e një pellgu me sipërfaqe të përgjithshme prej 19.582 km². Në këtë rrjet përfshihen: Liqeni i Shkodrës, lumenjtë Drin, Bunë, Kir e Gjadër. Veçanti në këtë aspekt përbën delta e lumit Bunë me ishujt e saj karakteristike aluvionale. Të para në aspektin e biodiversitetit dhe produktivitetit natyror, rrjeti hidrik, e sidomos ai hidrografik i Shkodrës, ka vlera të veçanta e pothuajse unike.

Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Gadishullin Ballkanik, me një sipërfaqe prej 368 km² nga të cilat 149 km² shtrihet në territorin Shqiptar dhe pjesa tjetër në Malin e Zi. Nga pikëpamja shkencore dhe njohuritë mbi liqenin, informacioni mbi biodiversitetin e tij është i pasur duke u konsideruar një rezervë biogjenetike me rëndësi europiane.

Velipoja dhe plazhi i saj- Përmendim këtu plazhin me gjatësi 14 km gjerësi rreth 300 m. Rëra e pashfrytëzuar dhe me aftësi shëruese si dhe uji i pastër, bën që Velipoja të frekuentohet çdo vit e më tepër nga pushues vendas dhe të huaj. Vendimi nr. 682, datë 2.11.2005 që shpall lumin Buna dhe territoret ligatinore rreth tij “Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur” ku hynë dhe ishulli i Franc Jozefit, rezervati i Velipojës, laguna e Vilunit, plazhi i Baks – Rrjollit dhe kënetat e Domnit është një tjetër avantazh për zhvillimin e turizmit në Velipojë.



Parku Kombëtar i Thethit

Zona e Thethit ka një sipërfaqe prej 2.630 ha, nga të cilat 1.680 hektarë janë pyje dhe pjesa tjetër janë kullota dhe sipërfaqe shkëmbore. Ai është shpallur tashmë “Park kombëtar” dhe mbikëqyret nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura. Thethi është i vetmi park kombëtar në qarkun e Shkodrës dhe i dyti për nga madhësia e parqeve kombëtare në Shqipëri pas Dajtit. Thethi ka rreth 70 burime ujore, me cilësi të lartë të ujit dhe të pastërtisë. Flora dhe fauna e zonës janë mjaft të pasura, me 1,100 lloje bimësh, që përbëjnë gati 1/3 e specieve bimore në vend.



Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore më një cilësi boniteti të lartë. Në përputhje me regjistrin e tokave Bashkia Shkodër disponon 87,300 ha tokë gjithsej. Me zbatimin e reformës së re administrative territoriale, pyjet dhe kullotat iu transferuan bashkisë së Shkodrës. Nga sipërfaqja e përgjithshme (përfshirë edhe zonat e mbrojtura), prej 52,520 ha, Bashkisë Shkodër i është transferuar sipërfaqja prej 43,806 ha, nga të cilat: pyje 30,992 ha, kullota 5377 ha, sipërfaqe jo produktive 5,556 ha, tokë djerrë 1,029 dhe bimësi pyjore 851.5 ha. Në këtë sipërfaqe gjenden të gjitha kategoritë e pyllit si pyll i rallë, pyll i dendur, shkurre të rralle, shkurre të dendur dhe livadhe e kullota. Ndërkohë për sa i përket prodhimit, mund të thuhet se në Shkodër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhohen në territorin e bashkisë në periudha të ndryshme kohore.

Demografia

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Popullsia e qytetit të Shkodrës është homogjene, me një popullatë e cila përgjithësisht ka patur lëvizje të brendshme demografike, pra nga zonat rurale drejt qytetit të Shkodrës, duke u përqëndruar në zonat e reja të banimit të krijuara pas viteve '90. Rritjen më të ndjeshme të popullsisë Shkodra e ka arritur pas vitit 1960 si rrjedhim i rritjes natyrale, 18/100 të popullsisë, si dhe gjatë viteve '90 si pasojë e lëvizjes nga fshati në qytet. Dendësia mesatare e popullsisë arrin 135 banorë/km².

Planet dhe strategjitë kryesore

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër, i miratuar me VKM Nr 5 datë 16.10.2017, i cili përfshin Strategjinë Territoriale, Planin e Zhvillimit të Territorit, Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe dokumente të tjerë shoqërues përbën kuadrin strategjik aktual për zhvillimin e zonës së Shkodrës, dhe ngarkon Bashkinë Shkodër së bashku me institucione të tjera për zbatimin e tij. Plani i Zhvillimit të Territorit shtrihet gjatë një periudhe afatgjatë 2015-2030, e cila përkon pikërisht me kohëzgjatjen e Agjendës 2030.

Vizioni afatgjatë 2030 i Bashkisë Shkodër, i përcaktuar në këtë dokument, shihet si ‘... një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike’. Vizioni 2030 mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve të zonës, sidomos ato ujore, ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor etj. dhe mbështetjen në vlerat kulturore dhe historike të zonës duke ofruar barazi në shërbimet ndaj qytetarëve, ruajtjen e mjedisit dhe përballje me sfidat e natyrës etj.

Mbështetur në këtë vizion, objektivat strategjike të zhvillimit synojnë ngritjen dhe përmirësimin e akteve ndërlidhëse rajonale, zhvillimi policentrik i bashkisë, përmirësimi i shërbimeve për qytetarët dhe qeverisja elektronike, fuqizimi i qendrave multifunksionale dhe shërbimeve sociale, mbështetja e zhvillimit ekonomik sidomos përmes turizmit, zhvillimit rural, akuakulturës, zonave ekonomike dhe sipërmarrjeve të reja, urbanizimi e rikualifikimi i hapësirave, restaurimi i vlerave historike, mbështetja e transportit publik, bicikletave dhe hapësirave sportive, integritit të komuniteteve në shoqëri, mbrojtja e mjedisit, mirëadministrimi i mbetjeve dhe mbrojtja nga rreziqet natyrore e ndryshimet klimatike etj.

Të gjitha ndërhyrjet sipas programeve strategjike në plan janë të shoqëruara me vlerësimet financiare, prioritetet dhe shtrirjen në kohë të zbatimit të tyre. Plani përmban gjithashtu edhe listën e treguesëve të monitorimit sipas kategorive dhe programeve strategjike si dhe rregullat e detajuara teknike për zbatimin e tij.

Në mënyrë të përmbledhur, dokumentat kryesorë strategjikë të bashkisë Shkodër janë si më poshtë.

Strategjia Territoriale për Zhvillim² është hartuar në bazë të VKM nr. 671, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 52 “Hartimi i Strategjisë Territoriale të njësisë vendore”. Strategjia ka si qëllim ofrimin e një vizioni, përcaktimin e fushave të zhvillimit, duke mbrojtur të drejtat e njërezve dhe sistemet natyrore, përcaktimin e prioritetëve dhe koordinimin e investimeve në territorin e Bashkisë Shkodër. Kjo strategji formon dokumentin bazë mbi të cilin është hartuar Plani i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja e Zhvillimit.

2 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/strategjia_territoriale_shkoder_1543.pdf

Plani i Përgjithshëm Vendor³ për Bashkinë Shkodër është hartuar në bazë të dispozitave ligjore të ligjit 107/2014, dt 01.10.2014 “Mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Plani ka si qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, planifikimin e masave për rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit, burimeve natyrore, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Analiza e Territorit⁴ mbështetet në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht, si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”. Në këto kushte, Bashkia Shkodër, për t’iu përgjigjur sa detyrimeve ligjore, aq edhe sfidave reale, ka punuar intensivisht për të përgatitur dokumentin e analizave si pjesë e procesit të Hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të saj.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor⁵ i Planit të Shkodrës është përgatitur bazuar në ligjin nr. 91/2013 “Për vlersimin strategjik mjedisor”. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është instrumenti kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si “një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e efekteve të tyre që në fazat më të hershme të vendimmarrjes”.

Plani Lokal i Mbrojtjes së Biodiveritetit⁶ është një dokument strategjik për ruajtjen e shumëllojshmërisë së gjallesave dhe ekosistemeve që ndodhen në territorin e Bashkisë Shkodër. Ky plan është i pari i hartuar në nivel vendor, i cili vjen në zbatim të strategjisë së Planit të Përgjithshëm Vendor për ruajtjen e mjedisit në territorin e Bashkisë Shkodër. Plani ka si qëllim rregullimin e përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit nëpërmjet integritetit të elementëve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Ndonëse Plani i Përgjithshëm⁷ Vendor 2015-2030 e ka fokusin e tij në mënyrë të natyrshme të orientuar drejt zhvillimit urban të zonës, sikurse u përmend më lart, plani është njëkohësisht dokumenti më i rëndësishëm afatgjatë strategjik që ndërlidh zhvillimin urban me atë ekonomik e social, mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave historike, mbështetjes së aktiviteteve ekonomike,

3 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_zhvillimit_territorit_1539.pdf

4 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/analiza_territorit_shkoder_1540.pdf

5 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/vleresimi_strategjik_mjedisor_per_ppv_shkoder_1541.pdf

6 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_biodiversitetit_shkoder_1542.pdf

7 Plani Lokal për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë e Shkodrës është përgatitur gjatë vitit 2020 nga z. Ilir Ciko për Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim në kuadër të projektit DEAR “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Axfordës 2030 brenda politikave vendore, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve” CSO-LA/2017/388-138 me Bashkinë Shkodër.

integritet shoqëror të shtresave në nevojë e kategorive sociale apo dimensionet e tjera që u përmendën më sipër. Duhet theksuar gjithashtu, që konteksti strategjik i zhvillimit të Shkodrës nuk kufizohet vetëm në Planin e Përgjithshëm Vendor, i cili është dokumenti kryesor strategjik, por plotësohet edhe me strategji apo plane të tjera afatmesme apo afatgjatë të përgatitur nga Bashkia Shkodër, sic mund të përmendim Planin Social etj.

Nga ky këndvështrim, dhe duke vlerësuar përputhjen e shtrirjes kohore të Planit të Përgjithshëm Vendor me Agjendën 2030, lokalizimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për rastin e Bashkisë Shkodër duhet të kryhet duke u mbështetur në drejtimet strategjike të këtij plani, në funksion të arritjes së objektivave të Agjendës 2030. Në këtë mënyrë, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, sikurse dhe në cdo vend tjetër të botës paraqesin një mundësi të re për të parë objektivat strategjike e afatgjatë të zhvillimit sikurse vështrohen sot anembanë globit, e në përputhje të plotë me përparësitë e specifikat kombëtare apo lokale si në rastin e Shkodrës.

Përfshirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në zhvillimin lokal të Shkodrës

Për të arritur në një detajim të tillë, krahas skemës së mësipërme, duhen patur parasysh së paku tre faktorë të rëndësishëm:

- a. Së pari, jo të gjitha synimet brenda Agjendës 2030 janë të lidhura me Bashkinë Shkodër. Për ta ilustruar, Objektivi 14 që mbulon jetën në ujë – dete, liqene, lumenj – është mjaft i rëndësishëm për specifikat e Shkodrës e cila është e rrethuar nga ujra si pak qytete në botë. Por psh. synimi 14.7 brenda këtij objekti, ka si fokus të tij përmirësimin e përfitimeve nga peshkimi, turizmi etj. nga përdorimi më i mirë i burimeve detare në shtetet ishujt të vegjël apo ato tepër të varfëra, raste këto të paaplikueshme për Shqipërinë apo Shkodrën. Si rrjedhojë, është e nevojshme që synime të tilla brenda Agjendës 2030 të përjashtohen nga konsiderata e lokalizimit për Bashkinë Shkodër.
- b. Së dyti, jo të gjitha synimet e Agjendës 2030 për rajonin e Bashkisë Shkodër janë përgjegjësi zbatimi e kësaj Bashkie. Sikurse u përmend edhe më parë, ndarja e niveleve të qeverisjes dikton përgjegjësi të ndryshme në arritjen e një synimi të caktuar e për rrjedhojë, arritja e një synimi të Agjendës 2030 mund të jete përgjegjësi ekskluzive e qeverisjes qendrore apo asaj vendore, ose e përbashkët e si e tillë të kërkojë bashkëpunimin dhe koordinimin mes tyre. Përshebull, brenda OZHQ 7 (Energjia), synimi 7.1 për aksesin universal në furnizimin me energji kërkohet kontributi i qeverisjes qendrore (furnizimi me energji) por dhe asaj vendore (strehimi\mbështetja sociale), ndërkohë që synimi 7.2 mbi mbështetjen e prodhimit të energjive të rinovueshme, është përgjegjësi thuasje

ekskluzive e qeverisjes qendrore, sikurse shumë prej synimeve të objektivit 11 janë përgjegjësi direkte e qeverisjes vendore.

- c. Së treti, jo të gjitha synimet e tjera të mbetura prej listës së 169 synimeve globale të OZHQ-ve (duke përjashtuar dy kategoritë e mësipërme) mund të jenë prioritete zhvillimi për Bashkinë Shkodër dhe identifikimi i synimeve të tillë kryhet përmes vlerësimit të çdo synimi të Agjendës 2030 me kuadrin strategjik të zhvillimit, pra Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe me prioritetet e identifikuara në takimet me përfaqësuesit e bashkisë dhe institucioneve të tjera.

Me këto konsiderata të rëndësishme, shqyrtimi i kujdesshëm i listës së 169 synimeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke i analizuar nga këndvështrimi i rëndësisë së tyre në zhvillimin strategjik të Bashkisë Shkodër, mbështetur dhe në konsultimet e kryera për këtë qëllim, rezulton në rreth 90 synime të OZHQ-ve, të cilat janë të rëndësishme në kontekstin e zhvillimit afatgjatë të Shkodrës. Këto synime paraqiten si më poshtë vijon:

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm ⁸	Synimet e OZHQ me rëndësi lokale në kontekstin e Bashkisë Shkodër
OZHQ 1: Eliminimi i varfërisë	1.1; 1.2; 1.3; 1.5
OZHQ 2: Eliminimi i urisë, siguria ushqimore, bujqësia e qëndrueshme.	2.1; 2.2; 2.3; 2.4
OZHQ 3: Jeta e shëndetshme	3.1; 3.2; 3.3; 3.6; 3.7; 3.9
OZHQ 4: Arsimi cilësor	4.1; 4.2; 4.3; 4.4; 4.5; 4.7; 4. a
OZHQ 5: Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.	5.1; 5.2; 5.3; 5.4; 5.5; 5.a; 5.b; 5.c
OZHQ 6: Ujë dhe ujësjellës-kanalizime për të gjithë.	6.1;6.2;6.3;6.4;6.5;6.6;6. b
OZHQ 7: Energji e përballueshme për të gjithë.	7.1; 7.3
OZHQ 8: Rritja ekonomike dhe puna.	8.3; 8.5; 8.6; 8.7; 8.8; 8.9;
OZHQ 9: Ndërtimi i infrastruktures e industrializimi	9.1; 9.3; 9.c
OZHQ 10: Zvogëlimi i pabarazisë	10.1; 10.2; 10.3; 10.4; 10.7
OZHQ 11: Qytete gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm.	Të gjithë
OZHQ 12: Modele të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.	12.2; 12.3; 12.4; 12.5; 12.7; 12. b
OZHQ 13: Ndryshimet klimatike	13.1; 13.3; 13. b
OZHQ 14: Përdorimi i qëndrueshëm i detit, liqenit dhe lumenjve	14.1; 14.2; 14.5; 14. b
OZHQ 15: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore	15.1; 15.2; 15.5; 15.9; 15. b
OZHQ 16: Shteti ligjor dhe institucionet	16.1; 16.5; 16.6; 16.7; 16.10
OZHQ 17: Partneriteti për financimin e objektivave	17.1;17.14;17.16;17.17;17.18;17.19

8 Plani Lokal për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë e Shkodrës

Vlerësimi i OZhQ



Objektivi 1

Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj

Objektivi Specifik 1.2: Deri në 2030, të reduktohet me të paktën gjysmën e përqindjes të femrave, meshkujve dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e varfërisë bazuar në definicionin kombëtar.

Treguesi 1.2.1: Përqindja e personave me të ardhura të barabarta të disponueshme nën pragun e rrezikut të varfërisë, i cili është vendosur në 60% të të ardhurave mesatare të disponueshme mesatare të vendit (pas transfertave sociale).

Synimi: Reduktim me të paktën gjysmën e përqindjes së burrave, grave dhe të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri.

Vlerësimi lokal

Në studimin⁹ e fundit të realizuar nga Banka Botërore në shkallë kombëtare, bashkia Shkodër rezultoi me:

- një nivel varfërie në 13.3%; një nivel mbi mesataren në shkallë kombëtare.
- numri i të varfërve në 17 850.

Përsa i përket numrit të familjeve në ndihmë ekonomike, Bashkia Shkodër rezultoi me një numër përfituesish prej 2.52% të familjeve, ku në shkallë republike numri i familjeve përfituese janë mbi 7 %.

Përsa i përket programit të bonusit të qerasë gjatë vitit 2020 kanë përfituar 3 familje.

9 <https://documents1.worldbank.org/curated/en/510751480409557798/pdf/110582-REVISED-PUBLIC-report-ALB-complete.pdf>

Më poshtë gjeni pasqyrën me të dhëna konkrete të numrit të familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020.

Numri i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për 2020												
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Bashkia Shkodër (Total)	1673	1663	1639	1724	1841	1924	1853	1826	1813	1775	1779	1765
Njësia Shkodër (Qytet)	268	262	251	260	276	283	278	157	268	263	275	270

Me hyrjen në fuqi të sistemit elektronik kombëtar për ndihmën ekonomike, në kompetencë të Bashkisë mbetet përzgjedhja e përfituesve të ndihmës ekonomike me fonde të kushtëzuar deri në 6%, kjo përzgjedhje bëhet nga familjet e refuzuara për mungesë pikësh nga sistemi elektronik kombëtar.

Kjo skemë përmbledhet në tabelën e mëposhtme:

Nr. i familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike me fond deri në 6%												
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. Familjeve	191	193	185	192	207	207	199	196	207	205	205	205
Fond deri në 6%	530	521	516	530	578	587	564	555	590	554	555	552

Nr. përfituesve në skemën e paaftësisë												
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Paaftësi	4199	4296	4363	4385	4382	4364	4339	4327	4209	4168	4145	4125
Inv. Pune	3373	3400	3401	3401	3401	3412	3347	3376	3364	3357	3357	3339

Objektivi Specifik 1.3: Zbatimi i sistemeve dhe masave të përshtatshme të mbrojtjes sociale kombëtare, për të gjithë dhe deri në vitin 2030 të arrihet mbulim i plotë me shërbime sociale të të varfërve dhe grupeve vulnerabël.

Treguesi 1.3.1: Përqindja e popullsisë e mbuluar me shërbime të mbrojtjes sociale, sipas gjinisë, duke dalluar fëmijët, personat e papunë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, të porsalindurit, viktimat e lëndimeve në punë dhe të varfërit dhe të prekshmit.

Vlerësimi lokal

Shërbimet me bazë komunitare të cilat filluan të krijohen gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Qendrat Komunitare “Për Familjen” janë njësitë bazë të ngritura dhe që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative.

Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 12 qendra komunitare; 6 në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave dhe Shalës. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare “Për Familjen” që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunkionale në shërbim të

fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra Rinore Atelie, në shërbim të të rinjve; qendra komunitare “Për Familjen” nr.6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me një kryefamiljar dhe fëmijë.

Numri i përfitueseve të shërbimeve nga qendrat sociale për 2020 është 6600.¹⁰

Gjithashtu, Bashkia Shkodër në zbatim të projektit “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” ka ndërtuar e vënë në funksion Qendrën Harmonia, e cila ofron shërbim të specializuar për fëmijët me çrregullime të spektrit autik.



Objektivi Specifik 1.4: Deri në 2030, të sigurohet që të gjithë meshkujt dhe femrat, veçanërisht të varfërit dhe grupet vulnerabël, të kenë të drejta të barabarta për burimet ekonomike, si dhe akses në shërbimet bazë, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimisë, burimeve natyrore, financiare, duke përfshirë mikrofinancën

Treguesi 1.4.1: Përqindja e personave që jetojnë në familje me akses në shërbimet bazë (ujë, kanalizime, kushtet e banesës, mbipopullimi, niveli arsimor i kryefamiljarit).

Përqindja e personave që vuan nga mungesa e aksesit në shërbimet bazë (ujë, kanalizime, kushtet e banesës, mbipopullimi, niveli arsimor i kryefamiljarit).

Vlerësimi lokal

Përgjatë këtyre 5 viteve Bashkia Shkodër ka investuar me fondet e saj dhe përmes asistencës teknike të bashkëpunimeve me KfW dhe SECO, GIZ dhe BE, në përmirësimin e rrjetit të ujesjelles kanalizime, duke integruar në nje rrjet të vetëm edhe fshatra apo zona informale të qytetit. Bashkia Shkodër dhe territori i bashkisë ka veçori për sa i përket rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, duke marrë parasysh këtu shtrirjen territoriale që ka nga alpet në Veri – në bregdetin e Velipojës, duke përfshirë këtu edhe liqenin e Shkodrës, lumin Buna e Drin. Këto veçori territoriale kanë kërkuar edhe studime dhe plane të detajuara për ndërhyrjet, si dhe për masat që duhen marrë për përmirësimin e rrjetit.

Të dhënat për këtë tregues për bashkinë Shkodër paraqiten në tabelën më poshtë në krahasim me 2019.

Të dhënat e programit	2019	2020
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (në %)	55	59
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (orë në ditë)	21	22

Përsa i përket menaxhimit të ujrave të ndotura, objektivat e programit buxhetor për për 12-mujorin e vitit 2020 ka qënë:

- Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të Bashkisë.

Ky shërbim realizohet nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a dhe treguesit kryesorë janë:

- Rreth 22,775 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Shkodër qytet + Nj.A
- 3,139 biznese në të gjithë Bashkinë janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Rreth 77 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të palidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike;
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërat të zeza në Velipojë, dhe në Shirokë;

Për sa i përket rrjetit të kanalizimeve dhe impianteve të përpunimit të ujërave të zeza, Bashkia Shkodër ka në funksionim dy impiante të depurimit të ujërave të zeza: për fshatin turistik bregdetar Velipojë si dhe fshatin Shirokë pranë liqenit të Shkodrës.

Përqindja e popullsisë që ka përfituar nga strehimi social përgjatë 2020.

Për të filluar zbatimin e programeve të strehimi social, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social.

Gjatë 2020 është shpallur Thirrja për aplikime për tre programe të strehimit social, e cila është bërë publike në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë. Për shkak të COVID-19 dhe në zbatim të VKM nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” procedurat e aplikimit janë pezulluar dhe janë rihapur me datë 01.06 2020.

Gjatë kësaj periudhe informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim ka qënë i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin

dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë dispozicion për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetaret, çdo ditë pranë zyrës me një ndalesë.

Për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë”, në fazën e parë kanë aplikuar 123 qytetarë, nga të cilët pas njoftimit për kualifikim në fazën e parë dhe plotësimit dokumentacioni, janë paraqitur për të plotësuar dokumentacionin 81 qytetarë.

Meqënëse bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota për vitin 2020, u zgjat afati i aplikimeve dhe në përfundim të procedurave, shqyrtimit në Komisionin e Strehimit, në total u miratuan 103 përfitues, të cilët vijnë në procedurat me institucionet financiare.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 është zbatuar instrumenti financiar për programin banesa sociale me qira “Subvencionimi i qirasë në treg të lirë”. Pas vlerësimit dhe shqyrtimit nga Komisioni i strehimit në varësi të fondit të parashikuar në buxhetin e bashkisë për këtë fond, u miratua në Këshill bashkiak lista me 3 përfitues në këtë program. Lista e aplikuesve të tjerë në këtë program është paraqitur për financim në ministrinë e linjës sipas parashikimeve ligjore.



Objektivi 2

Fund urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme

Objektivi Specifik 2.1: Deri në vitin 2030, ti japim fund urisë dhe të sigurojmë akses nga të gjithë njerëzit, veçanërisht të varfërit dhe njerëzit në situata vulnerabël, përfshirë foshnjat, në ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit.

Tregues: Ofrimi i ushqimit përmes menceve sociale për të pastrehët dhe të varfërit llogaritur me numrin e vakteve në ditë.

Vlerësimi lokal

Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian. Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve: 37 janë nevoja administrative. 77 kanë marrë shërbim mjeksor (35 rimbursim medikamentesh, 41 vizita të përgjithshme në qendrat shëndetësore, në spital dhe poliklinikë, 1 elektrocenfalogram e kokës dhe vizita ortopedi.), 13 fëmijë janë pajisur me kartela personale vaksinimi, 13 persona janë vaksinuar në qendër dhe pajisur me kartela vaksinimi, 133 fëmijë janë përfitues të përkujdesjes sociale, mbështetje në qendër me vakte ushqimore, shërbimin e higjenes, klasa paschkollore (përforcuese edhe përgatitore), aktivitete të shëndetit, këshillime, lojëra psiko-sociale dhe aktivitete verore.

Gjatë periudhës së COVID-19, 140 familje rom dhe 441 familje të komunitetit egjiptian të Bashkisë Shkodër janë mbështetur me pako ushqimore, pako higjienike, ushqime të freskëta dhe ushqime të shëndetshme. Gjithashtu është ofruar mbështetje financiare për 330 familje të komunitetit rom dhe egjiptian që i përkasin Bashkisë Shkodër, si dhe sesione informimi, takime me gra dhe nëna, sesione edukative dhe psiko-sociale me fëmijë.



Objektivi 3

Shëndet i mirë dhe mirëqënie

Objektivi 3 përfshin të gjitha dimensionet e shëndetit nga karakteristikat dhe sjelljet individuale, faktorët socio-ekonomikë si dhe shërbime dhe kërkime për të parandaluar ose trajtuar dhe kuruar sëmundjet.

Tregues të përkujdesit shëndetësor: Numri i institucioneve shëndetësore shtetërore dhe institucioneve të përkujdesjes sociale.

Vlerësimi lokal

Qëllimi i programit të “Shërbimet e kujdesit parësor” është:

- Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 kanë qenë:

- O1. Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

Me qëllim përmirësimit të shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përgjatë të gjithë vitit organizohen aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, si dhe merren masa për projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimin e infrastrukturës së ndërtuar. Si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në bazë të urdhrit Nr.132; dt.08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura.” aktivitetet e parashikuara gjatë kësaj periudhe janë realizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe protokolleve përkatëse për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

O1 Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor	Nr. i qendrave shëndetësore funksionale.	14
	Nr. i qendrave shëndetësore të Ndërtuara (të reja) dhe të rikonstruara;	3
	Nr. i personave që marrin shërbim në këto qendra shëndetësore	173029



Objektivi 4

Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë.


Objektivi Specifik 4.1 Deri në vitin 2030, të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, duke çuar në rezultate efektive të të nxënit.

Treguesi 4.1.1 Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve: (a) në klasat 2/3; (b) në fund të fillores; dhe (c) në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në (i) lexim dhe (ii) matematikë, sipas gjinisë.

Vlerësimi lokal

Në Bashkinë Shkodër zhvillojnë aktivitetin e tyre arsimor 66 kopshte nga të cilat 55 publike (24 kopshte në Njësinë Administrative të Shkodrës dhe 29 në dhjetë njësitë e tjera administrative) dhe 7 private. Përsa i përket arsimit fillor zhvillojnë aktivitetin e tyre 24 shkolla nga të cilat 23 janë publike dhe një është private. Sistemi i arsimit 9-vjeçar përbëhet nga 74 shkolla nga të cilat 62 publike (20 në Njësinë Administrative Shkodër, dhe 42 në dhjetë njësitë e tjera administrative) si dhe 12 shkolla 9-vjeçare private.

Ecuria¹¹ e numrit të fëmijëve të regjistruar në institucionet arsimore (publike dhe jopublike) sipas vitit akademik:




11 <https://www.unicef.org/albania/media/4086/file/Statistics%20Shkodra.pdf>

Numri i fëmijëve të regjistruar në institucionet arsimore (publike dhe jopublike) sipas gjinisë:

2020-2021	
Femra	9931
Meshkuj	10162

Ecuria e numrit të fëmijëve të regjistruar në institucionet arsimore (publike dhe jopublike) sipas nivelit arsimor



Niveli 0 – Arsimi parashkollor (çerdhe/kopësht)

Niveli 2 – Arsimi i mesëm i ulët/cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 1 – Arsimi fillor/cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 3 – Arsimi i mesëm i lartë (gjimnaz/profesional/social kulturor)

Objektivi Specifik 4.2 Deri në vitin 2030, të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në kujdes ditor dhe arsimin parashkollor, në mënyrë që ata të jenë gati për arsimin fillor.

Treguesi 4.2.2 Përqindja e fëmijëve të regjistruar në parashkollor dhe kopshte, sipas gjinisë. Përcaktohet si përqindja e fëmijëve në intervalin e caktuar të moshës që marrin pjesë në një ose më shumë program të organizuar të të mësuarit, përfshirë programet që ofrojnë një kombinim të arsimit dhe kujdesit ditor.

Vlerësimi lokal

Në territorin e bashkisë së Shkodrës kanë nisur vitin parashkollor në 55 kopshte publike e çerdhe mbi 2 mijë fëmijë¹².

Objektivi i bashkisë është:

Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin bazë parashkollor.

12 <http://ata.gov.al/2020/09/15/shkoder-mbi-2-mije-femije-nisin-vitin-parashkollor-ne-57-kopshte-e-cerdhe/>

Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet	1862
Numri i fëmijëve vajza që frekuentojnë kopshtet	989
Numri i stafit për fëmijët	172

Objektivi Specifik 4.a Ndërtimi dhe azhurnimi i mjediseve arsimore të përshtatura për fëmijët, aftësinë e kufizuar dhe gjininë dhe sigurimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive të të nxënësve për të gjithë.

Treguesi 4.a.1 Proporcioni i shkollave që ofrojnë shërbime themelore, sipas llojit të shërbimit.

Vlerësimi lokal

Në territorin e Bashkisë Shkodër ekzistojnë 90 shkolla dhe 2 konvikte të cilat administrohen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit (28 shkolla në qytet dhe 62 në Njësitë Administrative). Numri relativ i nxënësve që përfitojnë nga ky shërbim është 17.200, nga ku 11.227 nxënës në shkollat e qytetit dhe 5.973 nxënës në Njësitë Administrative.

- Në qytetin e Shkodrës funksionojnë 27 shkolla dhe 2 konvikte në qytet.
- Në Njësinë Administrative Rrethina funksionojnë 9 shkolla me 1.749 nxënës, 838 vajza.
- Në Njësinë Administrative Gur i Zi funksionojnë 7 shkolla me 1012 nxënës, 530 vajza.
- Në Njësinë Administrative Postribë funksionojnë 10 shkolla me 1098 nxënës, 559 vajza.
- Në Njësinë Administrative Ana e Malit funksionojnë 6 shkolla me 399 nxënës, 188 vajza.
- Në Njësinë Administrative Bërdicë funksionojnë 5 shkolla me 632 nxënës, 294 vajza.
- Në Njësinë Administrative Velipojë funksionojnë 6 shkolla me 562 nxënës, 273 vajza.
- Në Njësinë Administrative Dajç funksionojnë 6 shkolla me 267 nxënës, 124 vajza.
- Në Njësinë Administrative Shalë funksionojnë 5 shkolla me 136 nxënës, 63 vajza.
- Në Njësinë Administrative Shosh funksionojnë 3 shkolla me 24 nxënës, 14 vajza.
- Në Njësinë Administrative Pult funksionojnë 7 shkolla me 95 nxënës, 38 vajza.

Në shumë prej shkollave në Bashkinë Shkodër ekzistojnë laboratore të ndryshme për lëndët shkencore por të cilat kërkojnë rivitalizim shkaku që nuk përmbushin kriteret për ushtrimin e eksperimenteve të ndryshme. Kjo gjendje kërkon përditësim apo edhe krijim të hapësirave dhe të instrumenteve të cilat domosdoshmërisht ndikojnë pozitivisht në rritjen e cilësisë së arsimit.

Shkolla të mesme Profesionale janë 7 dhe konkretisht shkollat Kolë Idromeno, Arben Broci, Kolë Margjini, Teknologjike, Shejnaze Juka, Prekë Jakova dhe Zija Bulic. Shkolla 31 dhjetori është një shkollë 9 vjecare e cila ofron arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sistemi i ngrohjes në shkollat e Bashkisë Shkodër është në nivel të mirë, është i nevojshëm mirëmbajtja dhe përmirësimi nga lënda drurore në sisteme më të avancuara ekologjike.

Bashkia Shkodër zhvillon aktivitete të brendshme për promovimin e identitetit dhe vlerave lokale dhe kombëtare dhe gjithashtu nxit, mbështet dhe financoon aktivitetet kulturore, sportive dhe argëtuese për të rinjtë. Gjejmë vend për përmirësim në nxitjen dhe krijimin e programeve të shkëmbimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të ndryshme kombëtare dhe rajonale.¹³

Përveç arsimit parauniversitar ekziston edhe universiteti “Luigj Gurakuqi” me Fakultetet:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore me katër departamente:

Departamenti i Gjuhësisë, Departamenti i Letërsisë, Departamenti i Historisë, Departamenti i Gjeografisë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës me pesë departamente:

Departamenti i Matematikës, Departamenti i Informatikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Biologji – Kimisë, Departamenti i Infermierisë.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit me katër departamente:

Departamenti i Punës Sociale, Departamenti i Mësuesisë, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve, Departamenti i Arteve.

Fakulteti Ekonomik me tre departamente:

Departamenti i Administrim – Biznesit, Departamenti i Financë – Kontabilitet, Departamenti i Turizmit.

Fakulteti i Drejtësisë me tre departamente:

Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me tre departamente:

Departamenti i Anglistikës, Departamenti i Gjermanistikës, Departamenti i Romanistikës.

13 https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Shkoder.pdf



Objektivi 5

Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat

Objektivi Specifik 5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për të udhëhequr në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.

Vlerësimi lokal

Bashkia e Shkodrës e nënshkroi Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Menjëherë pas marrjes së këtij angazhimi publik nga Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi, i gjithë stafi i Bashkisë Shkodër është angazhuar maksimalisht për zbatimin në praktikë të Kartës Evropiane.

Përveç përkushtimit për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018- 2020 për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër është e para bashki që caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Sigurisht që Bashkia Shkodër, në mbështetje të kuadrit ligjor ndërkombëtar e kombëtar, si dhe të prioriteteve kombëtare dhe vendore, ka bërë përpjekjet e saj ndër vite për ndërtimin e një shoqërie të mundësive të barabarta, duke ndërmarrë një sërë hapash konkretë në këtë drejtim. Kështu, Bashkia Shkodër renditet ndër pesë bashkitë e para në Shqipëri që pilotuan modelin e ndërtimit të reagimit të koordinuar të komunitetit kundër dhunës në familje (sot Mekanizmi i Referimit), që në fillim të vitit 2008. Po kështu, duke filluar nga viti 2009, Bashkia Shkodër e përfshiu në organikën e saj Nëpunësen e Barazisë Gjinore dhe Koordinatorin

Vendore kundër dhunës në familje. Bashkia Shkodër ka dhënë gjithashtu shembullin e parë në mënyrën se si një njësi e vetëqeverisjes vendore mund të arrijë të prokurojë shërbime sociale, duke ofruar modelin e saj që në vitin 2010, në një kohë kur bashki të tjera në vend vazhdonin të insistonin se këto lloj prokurimesh ishin thuajse të pamundura për t'u realizuar, për shkak të boshllëqeve në legjislacionin në fuqi, etj. Por, pavarësisht këtyre veprimeve e përparimeve, barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave dhe djemve, në praktikë, në jetën e përditshme, është ende larg të qenit realitet!¹⁴

Treguesi 5.5.1 a Përqindja e mandateve që mbahen nga gratë në këshillin e bashkisë.

Bashkia Shkodër ka në këshillin e saj 25 gra këshilltare dhe 51 këshilltarë në total. Përqindja e grave këshilltare është 55%.

14 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_i_veprimit_per_bgj_shkoder_draft_1812.pdf



Objektivi 11

Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme.

Objektivi Specifik 11.2 Deri në vitin 2030, siguroni akses në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, veçanërisht duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë për nevojat e atyre në situata vulnerable, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe më të moshuarve.

Treguesi 11.2.1 Përqindja e popullsisë që ka qasje të përshtatshme në transportin publik, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi lokal

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithëfushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës.

Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

Qëllimi i programit të Transportit publik është:

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik ne do të përcaktojmë zonat me shpejtesi të limituar 30 km /orë.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 2020 kanë qënë:

O1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetesë më të mirë.

- Është realizuar vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore.
- Për sinjalistikën vertikale në gjithë qytetin janë vendosur rreth 1,300 tabela të

llojeve të ndryshme. Çdo vit me buxhetin e Bashkisë realizohet blerja e materialeve (tuba dhe tabela) sipas nevojave për zëvendësimin e tabelave të dëmtuara, si dhe përmirësimin e sinjalistikës. Është realizuar zëvendësimi i sinjalistikës së dëmtuar si dhe plotësimi i saj në qytet dhe në njësitë administrative, kryesisht në plazhin e Velipojës.

- Është realizuar investimi për vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë (bumeve).
- Shërbimi i sinjalistikës është realizuar edhe në njësitë e tjera administrative kryesisht në Nj.A Velipojë, para fillimit të sezonit të plazhit por edhe në zonat e banuara të njësive administrative Guri Zi, Bërdicë, Postribë etj.

O2. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër.

- Janë në funksion dy linja të transportit publik qytetas të udhëtarëve Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Zogaj. Krahas shërbimit qytetas në Bashkinë Shkodër realizohet shërbimi rrethqytetës me linja të rregullta që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër. Shërbimi kryhet me operatorë ekonomik të licencuar nga Bashkia Shkodër sipas frekuencave të miratuara:

Shkodër – Velipojë miratuar në 2004;

Shkodër – Dajç miratuar në 2016;

Shkodër–Trush miratuar në 2014;

Shkodër – Gur i Zi miratuar në 2009;

Shkodër – Ana e Malit miratuar në 2013;

Shkodër – Postribë miratuar në 2016;

Shkodër – Shalë miratuar në 2016;

Shkodër – Rrethina me 3 linja (Shkodër - Bleran – Bardhaj, Shkodër – Grudë e Re – Gucijë e Re, Shkodër – Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër) miratuar në 2016.

Subvensionimi i biletës së transportit urban realizohet për nxënësit dhe studentët (35% meshkuj dhe 65 % femra)dhe kategorive të veçanta të udhëtarëve që përfitojnë sipas dispozitave ligjore.



Bashkia Shkodër dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen e programit rajonal të GIZ/ORF Albania (Fondet e Hapura Rajonale për Evropën Juglindore) përfunduan zbatimin e projektit me fokus përgatitjet për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (Sustainable Urban Mobility Plan -SUMP).

Finalizimi i projektit shënoi pajisjen e policisë bashkiake Shkodër me bicikleta për tu përdorur në zona urbane, ndër urbane dhe gjatë kohës së plazhit.

Këto lehtësira do kontribuojnë në krijimin e një kulture tjetër të sjelljes dhe veprimin qoftë në aspektin social, mjedisor por edhe të kuptuarit të lëvizshmërisë urbane në cdo kohë. Një komponent tjetër i këtij projekti ka qenë pilotimi në bashkinë Shkodër i zbatimit të elementeve të vecantë të planit si përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes me bicikleta.

Objektivi Specifik 11.6 Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndikimeve të dëmshme mjedisore për banor të qyteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve urbane dhe të tjera.

Treguesi 11.6.1 Raporti i mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura rregullisht dhe të depozituara sipas normave, ndaj sasisë gjithsej mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara, sipas qyteteve.

Raporti i mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura rregullisht, të trajtuara dhe depozituara sipas normave, ndaj sasisë gjithsej të mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara. Mbetjet e ngurta urbane të trajtuara dhe depozituara sipas normave i referohen sasisë totale të mbetjeve të ngurta urbane të destinuara për trajtim ose depozitim tek objektet e miratuar të cilët së paku kanë arritur një nivel të ndërmjetëm kontrolli;

Vlerësimi lokal

Qëllimi i programit të Menaxhimit të mbetjeve është:

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 2020 kanë qënë:

O1. Rritja e mbulimit me shërbim.

Zona e mbulimit është rritur duke përmbushur objektivin e ofrimit të shërbimit sipas planit të miratuar dhe mbulimi i territorit administrativ të Bashkisë Shkodër. Me kontratat e reja që mbulojnë shërbimin e pastrimit për zonën lindore dhe perëndimore janë shtuar edhe territoret ku sot është sistemuar infrastruktura janë shtuar pika grumbullimi dhe i ofrohet shërbimi në Sheldi, Rragam, Prekal, Theth.

O2. Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane:

Mbulimi i kostos nga tarifa e shërbimit. 133%. Kjo vjen si rezultat i shërbimeve të cilat janë realizuar gjatë vitit por kanë ndikuar paraqitja e situacioneve me vonesë nga operatori i shërbimit zona qytet për 3 muajt e fundit.

Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit. 99% nga parashikimi i planit.

O3. Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit:

- Shpenzime për 1 ton mbetje të menaxhuar është 2796 lekë /t mbetje

- Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar është 3728 lekë /t mbetje.

O4. Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake.

Nën vëmendje përdorimi me efikasitet të burimeve financiare dhe rritja e transparencës dhe përfshirja e hallkave administrative, që sigurojnë administrimin e plotë të shërbimit, planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe verifikueshmërinë e shërbimit të ofruar.

Është shtuar shërbimi dhe strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontenerë shtesë edhe në të gjitha Njësitë Administrative.

Gjatë vitit 2020 janë lidhur kontratat e reja për të gjitha njësitë administrative në dy zona funksionale respektivisht për zonën Perëndimore njësite Velipoje, Dajc , Bërdicë Ana e Malit dhe për zonën lindore Njësitë administrative Rrethina Postribë Shalë dhe Gur i Zi. Procedurat këto të realizuara në zbatim të detyrimit ligjor sipas zbatimit të detyrimit ligjor për një menaxhim të drejtë, transparent dhe me efikasitet financiar në përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të sektorit të mbetjeve me zbatimin e VKM 319/2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së performancës dhe standartit të shërbimit përmes përmirësimit teknologjik, të rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe penalteteve. Me miratimin e Procedurës standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër dhe njësitë administrative realizohet më së miri përmirësimi i cilësisë të shërbimit duke rritur standartin e kontrollit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për zonat funksionale bazuar në kontratat e ofrimit të shërbimit të pastrimit.

Bazuar në të dhënat e mbetjeve të cilat raportohen të dërgohen në landfillin e Bushatit, qyteti i Shkodrës mban vlerën më të lartë të normës të grumbullimit të mbetjeve me 0.88 kg/banorë/ditë dhe NJA Velipojë me 0.5 kg/banorë ditë. Të gjitha njësitë e tjera kanë një normë grumbullimi të mbetjeve nga 0.1 deri në 0.26 kg/banorë/ditë.



Objektivi 12

Siguroi modele të qëndrueshëm të konsumit dhe prodhimit.

Objektivi Specifik 12.5 Deri në vitin 2030, të arrihet zvogëlimi i ndjeshëm i prodhimit të mbetjeve përmes parandalimit, zvogëlimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Treguesi 12.5.1 Shkalla e riciklimit lokal, sasia në ton e mbetjeve që riciklohen.

Ky tregues specifikon sasinë dhe raportin e sasisë së mbetjeve të ricikluara ndaj sasinë gjithsej të mbetjeve urbane të gjeneruara.

Vlerësimi lokal

Në territorin e Bashkisë Shkodër nuk regjistrohen aktivitete në lidhje me riciklimin dhe kompostimin në asnjë nga njësitë administrative. Qyteti i Shkodrës vite më parë ka testuar vendosjen e sistemit me tre kosha në rrugët kryesore të qytetit, por kjo skeme nuk funksionoi dhe bashkia përsëri ka aplikuar sistemin e grumbullimit të mbetjeve vetëm më një kosh.

Në të shkuarën për pjesën e qytetit ka patur përpjekje për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga sektori i biznesit, por përsëri këto përpjekje nuk kanë mundur të kenë sukses të mëtjeshëm. Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në rajonin e Shkodrës do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përzier, pa ndjekur procesin e ndarjes, për në landfillin e Bushatit. Aktualisht, ndonëse në bashkinë Shkodër mund të ketë patur kërkesa nga aktorë të rajoneve të tjera për të mbledhur disa fraksione të caktuara të mbetjeve të riciklueshme, popullsia Rome është ajo që kryen një aktivitet të përditshëm informal në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga PGM apo në depozitimet ilegale në territor.

Detyra kryesore e Bashkisë Shkodër është të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme si plastikë, letër&karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun shqiptar ashtu dhe në rajon. Afrimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane të bashkisë do të mundësojë zhvillimin e mëtjeshëm të këtij sektori dhe do të ulë barrën financiare të bashkisë.

Përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në rajon apo jashtë kufirit shtetëror do të jetë një nga detyrat kryesore të bashkisë për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat e partneritetit - publik-privat mbeten zgjidhjet më të mundshme për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori.



Objektivi 15

Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, për të ndaluar dhe përmbysur degradimin e tokës dhe për të ndaluar humbjen e biodiversitetit.

Objektivi Specifik 15.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe ujërave të brendshëm dhe shërbimet e tyre, në veçanti pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare

Treguesi 15.1.1 Zona pyjore si pjesë e sipërfaqes së përgjithshme të tokës.


Vlerësimi lokal

Në sistemin natyror¹⁵ pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike. Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik për prodhimin e lëndës së drurit dhe druve të zjarrit, punësimin në zonën rurale, në shërbimet mjedisore si reduktimi i dioksidit të karbonit, zbutja e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet, zbutet klima, reduktohet dioksidi i karbonit, pasi thithet nga pemët nëpërmjet fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kjotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet janë dakordësuar të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektivi arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kreditë karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni. Pyjet kryesore, gjenden në zonën malore të Bashkisë, në brigjet e lumenjve Drin, Buna, Kir dhe Shale. Sipërfaqet më të mëdha shtrihen në Brucaj me 2784 ha, lugina e Kirit, lugina e Shalës me 6760 ha, Sheldi 1889 ha, Drisht 5451 ha, Shosh 3175 ha dhe Shllak 955 ha. Në sipërfaqen pyjore dominojnë pyjet e larta bredhi dhe pisha, shkurre të ndryshme.

15 https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Pyjet_Bashkiake_1447_1.php

Ne kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rreshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e lumenjve dhe vijes bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike dhe vijes bregdetare. Kullotat janë shpërndarë në zona të ndryshme, por në Sheldi, ndodhen 1768 ha, sipërfaqe më të kufizuara në Shosh, Shalë, Rrjoll, Shalë.

a) pyjet dhe drurët pyjorë; b) shkurret; c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve; ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore; d) tokat pyjore, liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor); dh) sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, shkëmbinjtë, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;



Por nuk përfshihen në administrimin e Bashkisë Shkodër , Zonat e Mbrojtura si Parku Kombëtar i Thethit dhe Zona e Mbrojtur e Liqenit të Shkodrës ku përfshihen kodrat e Taraboshit si edhe Zona e Mbrojtur e Lumit Buna- Rezervati natyror i Velipojës. Kjo referuar pikës 3 të nenit 2 të Ligjit nr 9385/2005 “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar. Aktualisht në fondin pyjor të Bashkisë Shkodër gjenden llojet e durëve si ah, arrë, dushqë, pishë e zezë, pishë mesdhetare ,halorë të tjerë, gështnjë, panjë, fletorë të tjerë , verri dhe shkurre të ndryshme, akacie, bredh, bli , shkozë , lajthi etj. Sipas llojit të drurëe, në territorin e Bashkisë Shkodër sipërfaqja më e madhe është me drurin e llojit Ah, pastaj vjen Dushku, Shkurret e ndryshme dhe pyjet e Gështenjës me mbi 3000 ha.



Objektivi 17

Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Objektivi Specifik 17.1 Forcimi i mobilizimit të burimeve vendore, duke përfshirë mbështetjen ndërkombëtare ndaj vendeve në zhvillim, për të përmirësuar kapacitetin vendas për mbledhjen e të ardhurave dhe taksave.

Treguesi 17.1.2 Proporcioni i buxhetit të brendshëm financiar nga taksat vendore.

Vlerësimi lokal

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, sponsorizime dhe grante ndërkombëtare me skemë të plotë thesari.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, viti 2020 ishte një vit i cili për shkak të pandemisë COVID-19 që përfshiu të gjithë globin, krijoi problematika të mëdha në financa, në zhvillim ekonomikpor dhe në jetët e humbura. Bashkia Shkodër, si çdo njësi tjetër vendore dhe institucion publik i Republikës së Shqipërisë, u gjend në këtë situatë të jashtëzakoshme të pandodhur më parë, që në muajt e parë të vitit 2020.

Në kuadër të masave të marra për përballimin e situatës së krijuar nga shfaqja e rasteve të para me corona virus në Shqipëri, Kryetari i Bashkisë Shkodër nxori urdhërin me nr.230 datë 09.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, mbylljen e institucioneve arsimore dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19”.

Bashkia Shkodër propozoi pranë Këshillit Bashkiak, Projekt-Vendimin “Për disa ndryshime në VKB Nr.1 datë 22.01.2016 “për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër, të ndryshuar, në kushtet e krijuara nga pandemia Covid-19. Ky projekt vendim, edhe pas ndryshimeve të propozuara nga ana e këshilltarëve, u miratua nga Këshilli Bashkiak Shkodër, me Vendimin nr.25, datë 26.06.2020.

Në këtë VKB u vendos:

1. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, për të gjitha bizneset me xhiro vjetore deri në 14 milion lekë, ambulancat dhe OJF, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.
2. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, kategoritë si më poshtë vijon:
 - Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes).
 - Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes).
 - Kryefamiljarët gra, me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç) në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative
3. Shtyerjen e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore deri me datë 30 tetor 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve.

Për vitin 2020, nga tabela e realizimit të të ardhurave rezulton se përqindja e buxhetit të brendshëm financiar nga taksat vendore është 18%.

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2020 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 23% të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me 18%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 11%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura 13 %, tarifa për zënien e hapësirës publike 7%, tarifa e ndriçimit publik 5%, tarifa e gjelbrimit 3%, taksa e tabelës 2 %, tarifa nga institucionet e varësisë me 1 %, taksa e fjetjes në hotel 2%, gjobat 2%, taksa mbi truallin 2 %, etj.

Objektivi Specifik 17.3 Mobilizoni burime financiare shtesë për vendet në zhvillim nga burime të shumta

Treguesi 17.3.1 Investime të huaja direkte, ndihmë zyrtare për zhvillim përmes projekteve ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit ndërkufitar.

Vlerësimi lokal

Komuniteti i donatorëve dhe agjensive zbatuese të projekteve për zhvillim kanë qënë një partner i rëndësishëm në menaxhimin e sfidave administrative, ekonomike, sociale, mjedisore të territorit tonë.

Shkodra dhe komuniteti i saj, si një qendër e rëndësishme e trashëgimisë dhe përfaqësimit të vlerave kombëtare, por edhe në raportin e marrëdhënieve me partnerë, vlerëson dhe respekton kontributet dhe vlerat që vendet partnere kanë transferuar dhe përçuar nëpërmjet projekteve të zhvillimit, si nëpërmjet përthithjes dhe përdorimit afatgjatë të tyre, por edhe nëpërmjet përforsimit të ndjenjës së miqësisë dhe respektit për vendet dhe insitucionet mike.

Kështu vlerësojmë bashkëpunimin me mjaft vendet evropiane dhe ShBA, duke filluar nga organizmat si Komuniteti European, OSBE, USAID, UNDP, Banka Boterore dhe Banka Evropiane për Zhvillim, dhe shtetet mike si: Gjermania, Italia, Austria, Zvicra, Britania e Madhe, Spanja, Norvegjia, Hollanda, Suedia, Danimarka, Hungaria etj.

Shembuj bashkëpunimi:

- a) *Modeli i krijimit të agrobiznesit me USAID e cila ka për qëllim mbështetjen e sipërmarrësit me mjetet e nevojshme për të nxitur risinë, krijuar vende pune dhe ndërtuar ekonomi të zhvilluara.*
- b) *Bashkia Shkoder ka qënë e angazhuar maksimalisht me KfW, SECO si dhe të tjerë partnerë që kanë kontribuar në përmirësimin e rrjetit ujësjelles kanalizime.*
- c) *Marrëveshja për financimin e zgjerimit të rrjetit KUZ dhe të ujit të pijshëm në qytetin e Shkodrës dhe Rrethina, për financimin e impiantit të ujërave të zeza për qytetin, është ndër arritjet më të mëdha të këtij mandati qeverisës vendor.*
- d) *Bashkëpunimi me BERZH për projektin e Zhvillimit dhe Investimeve në bregun perëndimor të liqenit Shkodër.*
- e) *Anëtarësimi në forumin e qyteteve që lagen nga deti Adriatik dhe Jon, FAIC*
- f) *Bashkëpunimi me Hungarian Watertechnology Cooperation për çështje që kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizime.*
- g) *Bashkëpunimi me Bashkinë e Strasburgut, pjesë e rrjetit evropian të solidaritetit - Klubi i Strasburgut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.*
- h) *Bashkëpunimi me Bashkinë e Triestes në kuadër të projektit Yes Future.*
- i) *Bashkëpunimi me rajonin Emilia Romagna në kuadër të projektit DEAR.*
- j) *Bashkëpunimi me rajonin Friuli Venezia Giulia për liqenin e Shkodrës, etj.*

Zbatimi, monitorimi dhe rishikimi

Zbatimi i Agjendës 2030 në Bashkinë Shkodër mund të monitorohet përmes treguesve të monitorimit. Për fat të keq, treguesit globalë të monitorimit të OZHQ-ve që monitorohen në nivel kombëtar¹⁶, nuk disponohen të detajuar në nivel bashkie nga ana e INSTAT, ndaj sikurse u përmend edhe më lart, mënyra më efektive për ndërtimin e një sistemi monitorimi për OZHQ-të do të bazohet në përdorimin e treguesve të përfshirë në Planin e Përgjithshëm Vendor, duke e shoqëruar me mekanizmin e lidhjes midis këtyre treguesve dhe objektivave apo synimeve të OZHQ-ve.

Bazuar në ecurinë e progresit të zbatimit të Agjendës 2030 si dhe ndryshimit të mundshëm të prioritetëve strategjike, angazhimet e Bashkisë Shkodër në kuadër të Agjendës 2030 mund të rishihen për t'ju përshtatur në dinamikë procesit.

Rekomandim: Raportimi i progresit të arritur në zbatimin e Agjendës 2030 do të kryhet duke përdorur treguesit lokalë të monitorimit. Do të ishte e dobishme që Bashkia Shkodër të publikonte progresin e arritur nëpërmjet raporteve vjetore të përgatitura për këtë qëllim.

Plani i Punës

Më poshtë paraqitet plani i punës për zbatimin e Planit Lokal për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë Shkodër. Zbatimi i këtij plani do të kryhet në vijimësi gjatë periudhës 2021-2030 sipas aktiviteteve të përfshira në të dhe duke ndjekur një strategji zbatimi me hapat e trajtuara në këtë plan.

Rekomandim: Strategjia e zbatimit të lokalizimit të Agjendës 2030 duhet të ndjekë një plan të përcaktuar vjetor të ndërtuar mbi bazën e aktiviteteve në planin afatgjatë të punës për Agjendën 2030.

16 Raporti Bazë i OZHQ në Shqipëri, 2017

Plani i punës për zbatimin e Planit Lokal për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë Shkodër

Viti	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Aktivitetet										
Përcaktimi i përgjegjësiwe institucionale për zbatimin e Agjendës 2030										
Fuqizimi i kapaciteteve institucionale për Agjendën 2030										
Vendosja e prioriteteve lokale në Agjendën 2030										
Përcaktimi i objektivave të matshëm për synimet prioritare të Agjendës 2030, afatgjatë dhe afatmesëm										
Hartimi i mekanizmit të lidhjes midis treguesve të monitorimit dhe Agjendës 2030										
Planifikimi buxhetor										
Zbatimi, mointorimi dhe rishikimi i Agjendës 2030 për Bashkinë Shkodër										

